



## NEWSLETTER

Gusht 2024

Nr.8

### Mbikëqyrja e transmetusve dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

#### Transmetuesit

Lidhur me detyrimin për përdorimin e gjuhës në programe, transmetimit e përqindjes së raportuar vullnetarisht të muzikës në gjuhën maqedonase dhe transmetimit ditor prej së paku 12 orë program në radio, mbikëqyrje e rregullt programore është bërë mbi radiot rajonale Zona M-1, RFM, Urban FM, Skaj radio dhe EF-EM 90.3 Radio sportive. Nga mbikëqyrja është konstatuar se radio Zona M-1 me datë 6 gusht 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% muzikë në gjuhën maqedonase në periudhën prej orës 06:00 deri në orën 12:00, nga totali i përgjithshëm i ntransmetimeve muzikore të analizuar gjatë një ditë-nate.

Mbikëqyrje të rregullta për detyrimet për publikim impresium, publikim të informacionit që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, identifikim të transmetuesit, rregullat për transmetimin e komunikimeve komerciale audio, detyrimet për ofrimin e kuizeve ose forma të tjera të pjesëmarrjes në shpërblim, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik dhe transmetimi lojërave të fatit janë kryer mbi radiot RFM, Skaj radio, Urban FM, EF-EM 90.3 Radio sportive dhe Zona M-1. Nga mbikëqyrjet nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave të Ligjit për Media dhe LSHMAAV.

Pas marrjes së ankesës nga personi fizik, Agjencia ka krye mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore mbi serialin artistik „Prikazna za Sevda“ (Rrëfimet e Sevdës) të transmetuar në TV Sitel, lidhur me detyrimet për mbrojtjen e të miturve (fëmijëve) nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral. Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme të premierës dhe përsëritjes së episodeve të serialit artistik „Prikazna za Sevda“, shënuar si program i Kategorisë së Dytë (8+), për të cilën rekomandohet mbikëqyrja nga prindi / ose kujdestari, transmetuar në periudhën nga data 15 deri më 19 korrik 2024, nuk janë konstatuar shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

#### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore në disa operatorë – Infel KTV, Signal Net, Telekabel, Kabel Net, Multimedija Network L, Telent Kom, Altra Sat, Inel Internacional, IP Systems, Kabel L Net dhe Pet Net për detyrimin në paketën programore që ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv dhe për respektimin e detyrimeve për regjistrimin e shërbimeve programore dhe titrimin e shërbimeve programore që operatorët i ritransmetojnë. Gjatë kontrolleve nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave të LSHMAAV.